



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

Nga Seanca e njëzetetretë (XIII) e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, mbajtur më 27.12.2011 me këtë;

Rend pune:

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e datës 4.11. 2011 dhe seancës së jashtëzakonshme të datës 6.12.2011
2. Raporti financiar 9 muajor 2011
3. Propozim -Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoha komunale për vitin 2012
4. Propozim -Rregullorja për ndarjen e subvencioneve
5. Propozim- rregullorja për ndarjen e titujve të nderit, mirënjohjeve dhe shpërblimeve
6. Propozim- vendimi për shpenzimet e varrimit
7. Propozim i kryetarit të Komunës për lirim të disa bizneseve nga taksat komunale
8. Miratimi i planit të veprimit 2011-2012 të KKS-së në Komunën e Gjiçanit
9. Miratimi i planit të veprimit për mobilitet
10. Miratimi i planit të veprimit për ndriçim publik
11. Miratimi i raportit nga takimi i KKS-së të datës 20.7.2011
12. Miratimi i raportit nga takimi i KKS-së të datës 1.8. 2011
13. Të ndryshme

Seanca i filloi punimet në ora 10.15 min

Kryesuesi i Seancës
- Izmi Zeka

Në punimet e Seancës së njëzet e dytë morën pjesë :

Anëtarët e Kuvendit

Drejtorët e drejtorive

Kryetari i Komunës

Përfaqësuesit e OSB-së

Përfaqësuesit e MPL-së

Kryetarin e Bashkësisë Islame

Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut

Seancën e njëzetetretë (XIII) e hapi dhe udhëhoqi, kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë.

Mirëpo me theks të veçantë kryesuesi e përshëndeti Drejtorin Regjional të OSB-së për angazhimet e tij personale dhe në përgjithësi OSB-në për investimet e tyre të cilat po i bëjnë në institucionet komunale. Është e ditur më herët se ka qenë e botuar një broshurë në nivel të Komunës e sponzoruar nga OSB, por kësaj radhe është një investim pak më madh, sepse në një libër të veçantë janë përmbledhur të gjitha vendimet e KK-së prej vitit 2000 e deri më këtë vit. Ky ka qenë investim i OSB-së në vlerë prej 6 mijë eurove.

Me këtë investim dhe botim të këtyre vendimeve është një punë e mirë e cila e ndihmon transparencën, sepse vendimet e KK të Gjilanit mund t' i ketë çdo qytetarë dhe mund t' i sheh se cila vendime i ka marrë Komuna e Gjilanit.

E falënderoj drejtorin për angazhimin e veçantë i cili sot gjendet në këtë Seancë dhe fjalën do ta ketë kryetari i Komunës z. Qemajl Mustafa i cili do ta falënderojë drejtorin e Regjional të OSB-së.

Qemajl Mustafa- së pari kryetari e përshëndeti kryesuesin, këshilltarët, drejtorët, monitoruesit e Kuvendit nga Qeveria mediet, por në mënyrë të veçantë drejtorin e OSB-së në nivel të Regjionit i cili për kohën sa ka qenë në Gjilan ka treguar një përkushtim të veçantë për ta ndihmuar Komunën e Gjilanit i cili është edhe mision i OSB-së në Kosovë. Drejtori ka një përkushtim të veçantë për ta ndihmuar Komunën e Gjilanit dhe ta bëjë avancimin e fushave të ndryshme të jetës në Komunë.

OSB ka bërë një punë të veçantë të promovimi i ngritjes së vetëdijes të konsumimi i ujit të pijshëm të funksionalizimi i kompanisë dhe të ndërtimi i një relacioni përmes kompanisë për furnizim me ujë dhe trajtim të ujërave të zeza. Gjithashtu është përpjek që të bëhet një relacion në mes Komunës dhe kompanisë për trajtim të mbeturinave, kurse tash së fundi është një angazhim i veçantë të botimi i vendimeve të Kuvendit në një libër të veçantë. Ne me drejtorin e kemi një ide që të themelohet një medium i tipit radio- televizion, por në principin privato- publik.

Unë e falënderoj drejtorin për përkushtimin jashtëzakonisht të mirë që ka, vullnetin personal, përveç atij institucional për ta ndihmuar Komunën e Gjilanit dhe më vjen mirë që sot e ka mundësinë që t' i drejtohet Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

Faleminderit, z. drejtor dhe të uroj punë të mbarë edhe viteve të tjera.

Drejtori Regjional i OSB-së- faleminderit z. kryetar Mustafa për fjalët e mira që i thatë dhe është kënaqësi e imja që jam këtu dhe desha t' iu marrë pak kohë.

Siç e përmendi edhe kryesuesi, unë kam kërkuar nga stafi im që të shikoj sa rregullore gjenden brenda këtyre librave, por tash nuk mund ta them numrin, sepse ato ende vazhdojnë të aprovohen. Në fakt libri i përmbledh vendimet dhe rregulloret, kurse qytetarët duhet ta marrin atë në duar të tyre dhe të shohin se çfarë vendim ka marrë KK? Nga këto 1 mijë rregullore dhe vendime i kam përzgjedhur tri prej tyre.

Shpresoj z. kryesues që do të keni hapësirë ku ta lëni këtë mirënjohje në mesin e të tjerave dhe kam marrë vendimin e Komunës 11735 (aprovimi i planit urban të Komunës

së Gjilanit), rregullorja e dytë është 1026, (përdorimi zyrtari i gjuhëve në Komunën e Gjilanit) dhe rregullorja e tretë është 26819 mbi transparencën e KK- të Gjilanit.

Dëshira e ime e fundit si një qytetar i Komunës së Gjilanit është dhe shpresojmë se që të gjithë këta drunj që janë mbjell në qendër të Komunës të mbijetojnë gjatë procedurës së parë e më tutje.

Një fund drejtori regjional i ndan një Mirënjohje komunës së Gjilanit të cilën e pranon, kryesuesi i Kuvendit, por i cili gjithashtu ia dorëzon një mirënjohje drejtorit në emër të Kuvendit të Komunës e cila ceremoni u përcoll me duartrokitje.

Para se të fillojë Seanca me rend të punës me kërkesë të kryesuesit sekretaria konstatoi se në sallë janë 38 anëtarë të Kuvendit, kurse mungojnë; Jakup Bajrami, Zijadin Maliqi dhe Enver Hajrullahu.

U konstatua se ka kuorum për punë, kurse kryesuesi kërkon që të deklarohen këshilltarët se a kanë vërejtje në rend të punës?

Elisah Ymeri- unë kam vërejte lidhur me materialin, sepse neve do të duhej të na vijë materiali i shtypur si kopje fizike. Këta llap-topët të cilët i kemi marrë na nevojiten për ndonjë material shtesë për ta marrë në adresë elektronike dhe jo tërë materialin e seancës.

Ne po ta printojmë vetë, na duhet vetëm për seancë të sotme t' i printojmë 200 faqe?

Ne nuk kemi mundësi t' i analizojmë të tërë atë material në kompjuter për pa i shtypur dhe hedh në letër. E lus sekretarinë që herëve tjera materialin të na e sjellin në kopje fizike.

Vërejtja e dytë është që ky material që na vjen të na epet hapësirë për ta analizuar më gjatë, sepse jambi bindur se asnjë këshilltar këtë material të seancës së sotme nuk ka pasur mundësi për ta lexuar!

Sokol Haziri- urime të gjithëve Viti i Ri, duke dëshiruar që ky vit të jetë më i frytshëm dhe më i mbarë për të gjithë ne! Në takimin e KPF ne jemi pajtuar që vetëm 6 pika të procedohen për rend të punës në seancë dhe ky të jetë rendi i punës.

Unë nuk e kam të qartë se çka ka ndodhur, por po shihet se është rrit numri i pikëve 100% , pa konsultime me grupet politike dhe pa kaluar në KPF. Mua po më duket kjo jo serioze dhe kërkoj që këto pika të hiqen nga rendi i punës, por kam edhe një vërejtje që nëse raportohet për punën e KKSB-së, atëherë do të ishte mirë që të paraqitet një raport i vetëm dhe të raportohet për secilën mbledhje veç e veç.

Unë mendoj se është shumë i ngarkuar ky rend i punës dhe dot ë ishte mirë që të debatohet vetëm për ato pika për të cilat kemi arrit marrëveshje.

Arben Mehmeti- së pari e përshëndes prezencën e drejtorit të OSB-së në këtë seancë dhe i urojmë këtë Mirënjohje të cilën e mori nga Kuvendi, mandej përshëndes edhe përfaqësuesit e Bashkësisë Islame dhe atë MPL-së.

Kjo seancë me këto pika të rendit të punës, mendoj se është shumë me një rend të ngjeshur, por së pari e përshëndes punën e mirë të OSB-së, por në këtë seancë ka edhe faktor relevant dhe në këtë rast është opozita e cila asnjëherë nuk është vizituar dhe nuk është pyet për asgjë për atë se çka ka ndodhur në Komunën e Gjilanit!

Është mirë që në vitin 2012 të keni parasysh këto dhe të trajtoheni si faktor serioz dhe vetëm në këtë mënyrë mund të themi se ka qasje serioze ndaj të gjithë faktorëve relevant në Komunë.

Po ashtu edhe MPL-së ka qenë desh t' i ndahet një "mirënjohje" për jo seriozitet, neglizhencë dhe jo përgjegjësi ndaj shqetësimeve tona si opozitë!

Sa i përket rendit të ditës ne e fuqizojmë kërkesën për ta pasur një televizion lokal për të parë qytetarët e Gjilanit se çka ndodh në këtë Kuvend!

Kërkojmë që sa më shpejtë të veproni në këtë drejtim, sepse në këtë mënyrë e fuqizojmë transparencën të cilën e ka si mision OSB-ja dhe ne si KK.

Gjithashtu e mbështesë kërkesën e Elisaut që tash e tutje kopjet fizike të materialit të na dërgohen me kohë, por pa ngarkesa të tepërta, do të thotë ato që nuk janë shumë të rëndësishme të na dërgohen me imell, kurse dokumentet serioze është mirë t' i kemi ne si kopje fizike.

Po ashtu e mbështesë edhe kërkesën e shefit të grupit të AAK-së, z. Haziri që ky rend i ditës të reduktohet dhe të hiqet një numër i madh i pikëve dhe kjo seancë më tepër të jetë e karakterit solemn, sepse është fundi i vitit.

Unë kërkoj që pika 2 e rendit të ditës, raporti financiar 9 muhor është i vonuar dhe tash jemi në fund të muajit të 12, prandaj ky raport mund të na epet vitin e ardhshëm dhe të jetë raport vjetor.

Po ashtu pika tre; rregullorja për taksa dhe ngarkesa për vitin 2012, këtu kemi kërkesa për plotësime dhe ka nevojë për plotësime, prandaj sot është mirë që ta nxjerrim një vendim që rregullorja e vitit 2011 të vlejë deri në aprovim të rregullores së re.

Pika nën 4; rregullorja për ndarje të subvencioneve duhet të kalojë në Komisioni për akte normative, sepse nuk ka kaluar, prandaj propozoj të hiqet.

Gjithatë edhe pika 7 të jetë në seancën e ardhme, sepse është e lidhur ngushtë me pikën 3 të rendit të punës dhe duhet një debat më detal dhe serioz në seancë.

Jemi të interesuar që kësaj seance më tepër t' i japim karakter solemn, sepse është fundi i vitit dhe nuk mendojmë se rrezikohet procesi i punëve në KK.

Qemajl Mustafa- së pari unë e çmoj kontributin e Arbenit dhe të tjerëve për ta racionalizuar sot këtë seancë, kurse solemne të jetë dreka, kurse urimet do të duhej rezervuar në fund të seancës. Ne në KPF jemi marrë vesh që për Rregulloren për taksa të procedojmë në seancë dhe materialet të sillen në Kuvend, kurse sot paraqitet kërkesa për ta heq nga rendi i punës. Kjo nuk duhet të jetë kështu për shkak të dy gjërave; një është se jemi marrë vesh dhe e dyta është se mbaron viti fiskal dhe ne në vitin e ri fiskal duhet të hyjmë me rregullore të taksave.

Këtu duhet bërë racionalizim, sepse jo në mënyrë të kujdesshme është vu pika 7 dhe 3, prandaj duhet të jetë 7 pjesë e 3, sepse ajo është një pikë.

Të konsiderohet se 3 dhe 7 është një dhe 11 dhe 12 në fakt është një pikë dhe na merr shumë pak kohë. Unë jam që pika 9 dhe 10 të miratohen, por nëse duhet t' i heqim mund ta bëjmë këtë dhe i vendosim në seancën e janarit.

Rregulloret nëse i kanë kaluar procedurat jam për t' i fut në rend të punës, nëse jo atëherë duhet të hiqen nga rendi i punës dhe të kalojnë nëpër procedura.

Izmi Zeka- në fund po e mbyllim kështu; raporti financiar mbetet për vitin e ardhshëm.

E dyta; rregullorja për ndarje të subvencioneve, po e përsëris mos i sillini për pa kaluar në komisionin për akte normative, kjo hiqet shkon në komision dhe pastaj vjen në Kuvend.

Pika 8 procedohet, kurse 9 dhe 10 hyjnë në seancën e janarit.

Do të thotë 2, 4, 3 dhe 7 janë një pikë.

Po mbetën pika 3 duke ia bashkëngjitur edhe pikën 7, pika 4 hiqet, pika 5 mbetet i ka kaluar procedurat, pika 6 mbetet, mandej shkojnë dy raporte e KKS-së do të thotë pika 11 dhe 12 dhe më në fund vjen edhe ; miratimi i planit të veprimit 2011-2012 të KKS-së dhe të ndryshme.

Sadudin Berisha- ne e kemi parë se pika 3 dhe 7 kanë lidhje të drejtpërdrejtë, sepse kanë të bëjë me lirim të disa bizneseve që e bëjnë fillimin e punës së tyre prej fillimit të vitit të ardhshëm. Mirëpo i kemi dy vendime të ndryshme të cilat si të ndara duhet të miratohen ose mos miratohen, kështu që janë jo një pikë, por dy duhet të propozohen për aprovim njëra pas tjetrës.

Izmi Zeka- aprovohen veç e veç, por debatohen bashkë, prandaj ju lus kush është për miratim të rendit të punës?

Aprovohet rendi i punës me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit

Procesverbali

Aprovohet procesverbali pa vërejtje i seancës së rregullt i datës 4.11.2011 dhe i seancës së jashtëzakonshme i datës 6.12.2011

3. Propozim -Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2012

Nuhi Nuhiu- ne si Drejtori e Financave në bashkëpunim me drejtoritë e tjera jemi munduar që kjo rregullore të del sa më efikase, sa më e pranueshme dhe më e thjeshtë!

Këtë vit në këtë rregullore të bizneset e kemi një ngritje prej 12%, sepse këtu janë fut edhe disa veprimtari të cilat nuk kanë qenë të ngarkuara me taksë komunale.

Nga kjo siç po shihet nuk kemi bërë ngritje, por edhe dihet se është edhe një propozim nga USAID-i që taksat për biznes të hiqen nga të hyrat vetanake dhe besoj se në vitin 2013 dhe 2014 ky inkasimi së bashku me atë për leje të ndërtimit do të hiqen.

Në vijim të fjalës së tij drejtori i Financave edhe disa sqarime të tjera, duke theksuar sidomos taksat e reja të cilat janë shtuar në bujqësi, shëndetësi dhe urbanizëm, të cilat propozime janë në material të seancës.

Kërkoj nga anëtarët e Kuvendit që sot ta aprovojnë këtë rregullore, sepse kjo është një ndër rregulloret më të rëndësishme të Komunës?

Ejup Haziri- grupi i këshilltarëve të PDK-së është për atë që rregullorja për taksa ngarkesa dhe gjoba të miratohet në parim, por tarifat të jenë ato që kanë qenë në vitin e kaluar dhe jo me rritjen që është paraparë, sepse rritja e taksave, gjobave dhe ngarkesave duhet ta ketë edhe një bazë të ngritjes ekonomike.

Ne në bazë të analizave që i kemi bërë, nuk kemi vërejt se ka ndonjë ngritje substanciale të biznesit dhe në tërë Kosovën jo që ka vetëm stagnim, por në disa raste ka edhe degradim.

Edhe njëherë po e paraqes qëndrimin tonë, pra jemi që të miratohet rregullorja e mëparshme në parim, kurse kjo e tashmja e cila na është propozuar ka nevojë për një analizë më të mirë dalëngadalë, duke analizuar biznes pas biznesi dhe ta aprovojmë pa gabime. Kemi nevojë për një analizë më të gjatë, vitin 2012 jam që ta vazhdojmë me të njëjtën rregullore, analizat t' i bëjmë gjatë këtij viti dhe kështu të jemi të gatshëm për vitin 2013.

Arben Mehmeti- edhe ne jemi për ta aprovuar në parim, por po shihet se është një jo harmonizim në mes ekzekutivit dhe grupit të këshilltarëve të PDK-së të cilët e udhëheqin pushtetin, sepse në seancë kemi qëndrim të kundërt nga ajo që na ka ardhur si material nga kryetari i Komunës dhe Këshillit të drejtorëve.

Me këtë shihet se këtu është një jo seriozitet në qasje në këtë drejtim.

Në parim ne si grup i LDK-së e mbështesim rregulloren e cila ka qenë deri më tani me disa propozime konkrete për t' i ul disa taksa dhe gjoba në disa shërbime, të cilat grupi i ynë veç e veç do t' i propozojë.

Drejtori e theksoi se nuk ka ngritje, por siç po e shohim ne këtu ka ngritje 500% te taksat dhe gjobat dhe nuk dimë arsyen pse drejtori e tha këtë?!

Gjithashtu edhe disa kategori në të cilat ka zbritje është më mirë të specifikohen më detalisht, sepse ne jemi në fazën e hartimit të ligjeve që i referohen kategorive të caktuara, prandaj është mirë që këto kategori të mbesin për një fazë tjetër të zbritjeve. Këtu janë të specifikuarë të burgosurit politik, veteranët e luftës, për të cilat kategori janë duke u hartuar ligjet konkrete.

Po ashtu te pagesat e shërbimeve e kam vërejt se ka shuma jashtëzakonisht të mëdha dhe që me ligjet aktuale në fuqi të thesarit dhe të sferës ekonomike, mbi dhjetë euro (nëse nuk jam gabim), pagesa duhet të bëhet përmes bankave, kurse këtu kemi pagesa të cilat bëhen kesh dhe jashtë kësaj rregulle.

Këto janë vërejtje në parim si grup i Këshilltarëve të LDK-së, kurse secili në fushën e vet do t' i japë vërejtjet dhe sugjerimet konkrete.

Arben Malqi- së pari e përshëndes drejtorin e OSB-së, kryetarin e Bashkësisë Islame, kryetarin e Komunës dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në këtë seancë.

Lidhur me këtë rregullore edhe ne jemi të pajtimit që të jetë po ajo rregullore e cila ka qenë më herët (e vitit që po e lëmë pas), sepse kemi shumë vështirësi ekonomike të cilat do të na përcjellin edhe në vitin 2012, prandaj në emër të grupit propozoj që të vazhdojmë me të njëjtën rregullore edhe në vitin 2012.

Qemajl Mustafa- ne kemi diskutuar për këtë rregullore tri ditë në Këshillin e drejtorëve për pa nxituar, vetëm për të dal një rregullore më e mirë se kjo aktualja!

Duhet të bindeni se është më e mirë! Diku prej shumë, kur është mbledhë e tërë kolona e taksave te të gjitha bizneset doli që 3 mijë euro ishte ngritja. Kjo 3 mijë euro ishte ngritje te disa biznese që kanë pas taksa shumë të ulëta! Kjo ka ndodh te kazinot, diskobaret etj. Mandej kemi bërë edhe një kategorizim, te marketet, super marketet dhe hipermarketet, sepse këtu nuk ka qenë një kategorizim i duhur me sipërfaqe dhe ne e

kemi shkoqitur pak më mirë dhe hiper marketet i kemi ngarkuar më shumë, por kemi shkuar gradualisht në zbritje.

Këto diferenca kur i kemi mbledh kanë bërë 3 mijë euro e cila në fakt nuk është rritje, por është një kualifikim i duhur i bizneseve dhe në fakt nuk kemi rrit asgjë.

Nëse kësaj ia shtojmë propozimin për heqjen e taksave për të gjithë prodhuesit për pesë vitet e ardhshme dhe lirimin nga taksat e bizneseve fillestare e të atyre jo formal e që formalizohen deri në fund të vitit, do ta shihni se kjo rregullore është shumë më e lehtë se sa rregullorja e vitit që po shkon, sepse po heqim taksat për prodhuesit, për bizneset e reja që po regjistrohen dhe për ata që deri më sot nuk kanë qenë formal.

Unë kam propozuar që këta jo formal të jenë të liruar për dy vjet, tri për ata që regjistrohen dhe për 5 vjet për prodhuesit.

Për këtë si u tha nga drejtori propozohet nga miqtë tanë të cilët janë në Komunë, që taksat për bizneset të kenë lehtësime nga viti në vit deri sa të bien në zero!

Unë iu lus që së pari të diskutojmë për këtë pjesën e propozimit tim për lirim të kategorive dhe kur e marrim këtë qëndrim, atëherë diskutojmë për këtë të dytin, sepse në fakt kemi zbritje mjaft të madhe.

Sokol Haziri- grupi i këshilltarëve të AAK-së është përgatitur edhe sot për ta diskutuar këtë temë, por ne e votuam këtë pikë të rendit të punës dhe është mirë të fillojmë të kemi propozime konkrete, sepse as janari, shkurti dhe marsi nuk na bënë më të zellshëm dhe kemi pasur mundësi që ta trajtojmë këtë temë dhe të dalim sot me propozime konkrete.

Nuk besoj që sjell as një ndryshim shtyrja e një teme të tillë.

Sidoqoftë, ne nuk duhet t' i shtyjmë proceset në vazhdimësi, sepse shtyrjet nuk sjellin asgjë të re.

Abdyl Aliu- një dokument aq me rëndësi për Komunën e Gjilanit, sikur ta kishte pasur një rrugëtim të mirë ashtu si e kërkon rendi me siguri nuk do të vinte në këtë formë në Kuvend! Unë së pari kam vërejte në atë se pse ky dokument me kaq rëndësi nuk është shpërndarë nëpër komitete?

Mirëpo edhe drejtori dhe kryetari e thanë Këshilli i drejtorëve, por duhet shtruar pyetjen ku janë bizneset, ku janë qytetarët dhe ku janë grupet e interesit për ta dhënë edhe ata kontributin e vet në hartimin e kësaj rregulloreje?

Ne kemi punuar dhe i kemi disa vërejte: së pari te neni 4, në shumë raste ngritja është 25% e jo 12%, por ka edhe 46, 106%, por ka edhe 500%.

Në vitin vijues të bëhet një ngritje e tillë kur ka varfëri dhe papunësi për mua është a pakuptimtë. Neni 5 është, konkretisht pika 5.2 ku thuhet se nga pagesa e tarifës dhe ngarkesa 3.1 (pranimi i kërkesës 5 euro) thotë lirohen, por ndër të tjera thotë se lirohen pika d.- kompanitë publike me rastin e ndërhyrjes në infrastrukturë për kërkim të lejes. Kjo për mua nuk ka kuptim! Këtë po them se KEK-u, Hidromorava, Higjiena duhet ta paguajnë një taksë të tillë. Unë kërkoj që edhe këto kompani publike të paguajnë taksë të tillë.

Neni 6 pika 6.2 bëhet fjalë për komisionin për mbikëqyrje dhe pranim teknik të objekteve me sipërfaqe mbi 800m² do të jetë 1% e vlerës së investimeve të objektit. Për këso raste ka ndërmarrje të posaçme e cila e bën mbikëqyrjen, prandaj po pyes pse duhet formuar një komision dhe ai të kompensohet për të njëjtën punë? Propozuesi i

këtij 1% nuk e di a e din sa është vlera investive e një objekti për afërsisht? Mandej nuk e di a e din sa del metra katror për mbikëqyrje?

Me këtë 1%, çmimi për mbikëqyrje del 3.5 euro për m². Çmimi real i një kompanie për mbikëqyrje është maksimumi 1 euro për m². Në bazë të kësaj shihet se një anëtar i komisionit i takojnë 3 mijë deri 4 mijë euro për një mbikëqyrje.

Në vijim të fjalës z. Aliu pat vërejtje te neni 59, 60 ku përmenden organet e kontrollit ndërtimor, por këtë e rregullon ligji. Gjithashtu edhe leja e kontrollimit teknik (kontrollimit teknik) është e rregulluar me këtë ligj.

Mandej është neni 49, 50, 51 të gjitha janë të rregulluar me këtë ligj, prandaj është mirë që t' i lexoni edhe ju!

Kjo në tërësi është jo ligjore, sepse me ligj është e paraparë se çfarë dokumente nevojiten për kontrollim teknik.

Në vijim të fjalës së tij z. Aliu pati vërejtje edhe tek pika 6.6 në të cilën bëhet fjalë për përjashtim nga pagesa për kompensim të tokës ndërtimore, unë mendoj se duhet shtuar edhe këtë: “ duhet të lirohen nga pagesa edhe objektet që janë të regjistruar në Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër”.

Pika 6.9 thotë se nëse tejkalohej etazhiteti dhe gabariti investuesi gjobitet 300% nga shuma bazë nëse lejojnë kushtet urbanistike! Unë tash kam pyetje se duhet dënuar Urbanizmin që nuk i a ka dhënë sipërfaqen e ndërtimit sipas kushteve urbanistike të kompanisë? Kjo nuk ka sens për mua! Pse të dënohet kur lejojnë kushtet urbanistike? Dënim duhet të ketë, por 300% është tepër!

Në këso raste ka qenë desh të bisedojmë edhe me ndërtimtarë dhe grupe të tjera të interesit!

Ibish Ibishi – edhe ne si grup i AAK-së në parim propozojmë propozime të reja dhe me këtë propozime do ta kishim përkrah një rregullore të tillë. Ne e kemi shqyrtuar këtë propozim- rregullore dhe kemi vërejtur shumë mangësi dhe kemi konstatuar se duhet një debat më i mirë për këtë rregullore. Mirëpo për ta debatuar për një rregullore në një seancë në ditën e fundit të vitit është shumë pak kohë, por edhe më ngarkesë kur është edhe një pikë për nxjerrje të vendimit për lirim të disa bizneseve prodhuese.

Unë mendoj se ky propozim ka qenë desh të bëhet më herët dhe nëse do të ishte miratuar, atëherë do të ishte desh të propozohet miratimi i kësaj rregulloreje, për taksa, tatime dhe gjoba.

Në këtë rregullore te neni 4, nuk po shoh se ka propozim për ngritje vetëm te kazinot dhe diskobaret dhe lojërat e fatit ashtu siç u tha, sepse ka ngritje në të gjitha lëmitë ekonomike dhe bizneset.

Jam i mendimit se me këto ngritje nuk do të pajtohen as ata që bëjnë biznes në Komunë tonë dhe askush nuk do të jetë i kënaqur, sepse është i mangët propozimi i kryetarit.

Unë nuk shoh të arsyeshme që të lirohen vetëm bizneset prodhuese, sepse ky propozim ka qenë desh të jetë më gjithëpërfshirës për bizneset, atëherë do të ishin pajtuar të gjithë. Kjo ka qenë desh të bëhet me një përqindje për lirim dhe jo sipas propozimit të kryetarit.

Tek propozimet e reja përpos te përpunimi i pemëve dhe perimeve dhe te kultivuesit e drunjtve dekorativ që kanë lirim, tek bizneset e tjera janë propozuar ngritje të taksave.

Për këtë po e them se na duhet një kohë më e gjatë për ta analizuar këtë rregullore, sepse ne kemi mjaft vërejtje.

Kjo propozim-rregullore për mua dhe grupin e AAK-së është e pa pranueshme.

Bahrie Veseli- për fillim e përshëndes Zyrën për informim e cila e ka hartuar një Buletin me të cilin po shihet se kush udhëheq, por ajo vërejtja më kryesorja është se Zyra për Barazi Gjimore nuk ekziston fare sipas këtij Buletini! Gjithashtu edhe aktivitet e grave nuk ekzistojnë sipas këtij Buletini, prandaj urime për këtë lëshim, por edhe për gabime të tjera drejtshkimore etj. !

Unë do të jem konkrete dhe në këtë rregullore për taksa, tatime dhe gjoba, sepse i kam nxjerr disa propozime:

Te tarifa 3.1- përpilimi dhe lëshimi i aktvdekjeve në vend 5 euro të jetë 3 euro

-lëshimi i certifikatave mbi identitetin prej 3 në 2 euro

- lëshimi i vërtetimi për varrim gjithashtu nga 3 në 2 euro

- pagesa për shërbimet e kryera prej pikës 1 -27 lirohen të gjitha ato kategori të cilat janë të shumta, propozoj që të lirohen edhe gratë kryefamiljare.

Mandej te disa biznese si janë bankat prej 800 euro të jetë 1.000 euro

Këmbimoret nga 240 në 400 euro

Autotaksit dhe veprimtaritë e njëjta nga 240 të zbresin në 200

Kooperativat bujqësore prej 100 euro të ketë zbritje në 80 euro

Shitoret e tepihëve prej 160 të zbresin në 100 euro

Bukëpjekësit prej 120 të zbresin në 100

Riparimet e mobileve gjithashtu prej 120 në 100

Ortarët prej 70 në 50

Leja për prerje të asfaltit të ketë ngritje nga 70 euro në 100, sepse shpesh po ka dëmtime të rrugëve.

Në disa tarifa për zona rurale të ketë disa ndryshime, tarifa e parë prej 5 në 4 euro dhe kështu me radhë 5, 3 dhe 2 euro.

Sadudin Berisha- së pari dua ta di se me cilin dokument propozimi për lirim e disa kategorive biznese me cilin dokument është bërë?

Unë i kam dy dokumente njërin nga kryetari i Komunës, kurse tjetrën në emër të kryesuesit të Kuvendit? Këto dy dokumente njëra me tjetrën kanë ndryshime dhe për këtë krijohet konfuzitet! Në një dokument janë 5 pika, kurse në tjetrin vetëm tri, ku bëhet fjalë për lirim të biznesve. Cili është valid dua ta di së pari?

Sadri Arfi- ju e dini se çdo akt i cili vjen më në fund e eliminon atë të mëparshmin. Këshilltarët më parë e kanë marrë një rregullore për taksat, por në KPF është thënë se Këshilli i drejtorëve do t' i shqyrtojë propozimet dhe pastaj do ta merrin rregulloren e spastruar. Në ndërkohë Këshilli i drejtorëve e ka mbajtur takimin është spastruar rregullorja dhe ky është vendimi final të cilin e keni në dorë.

Sadudin Berisha- ne e dimë se para një muaji e kemi miratuar buxhetin komunal për vitin 2012 i cili do të duhej të ishte dokumenti final i planifikimit buxhetor për Komunën e Gjilanit edhe për të hyrat vetanake. Kjo dëshmon se ky dokument për të

cilin sot po diskutojmë do të duhej të ishte i miratuar dhe i diskutuar para se të miratohej buxheti i Komunës së Gjilanit.

Së dyti në këtë rregullore kemi ndryshime të dukshme ndaj vitit të shkuar, sepse kemi ngritje të shumta të taksave në biznese prodhuese dhe jo prodhuese.

Te propozimi për lirim të disa bizneseve i kam disa vërejtje të cilat i bëj në emër të grupit të LDK-së:

Në pikën 1 (citohet nga z. Berisha) dhe në vijim e thotë se e mbështesim si qëllim të mirë dhe në parim pika e parë është e drejtë.

Mirëpo pika dytë (bizneset fillestare) nuk e kam të qartë prodhuese apo jo prodhuese?

Këtu thuhet ; të cilat regjistrohen deri në fund të marsit të vitit 2012.

Me këtë nuk mund të pajtohem, sepse ne nuk mund ta ndajmë vitin fiskal financiar me mundësinë e regjistrimit të një biznesi në tre mujorin e parë dhe të lirohen nga taksat, kurse të ngarkohen me taksa dhe tarifa bizneset të cilat regjistrohen pas 1 prillit.

Ky pasues duhet të jetë brenda vitit 2012, çdo biznes që regjistrohet dhe ngarkesat fillojnë nga dita e regjistrimit për periudhën e dhënë.

Propozimi i ynë është që pika e dytë të ketë këtë formulim: “bizneset prodhuese dhe jo prodhuese fillestare të regjistruara gjatë vitit 2012 të lirohen nga tarifat dhe taksat dhe ngarkesat komunale për tri vitet e ardhshme nga dita e regjistrimit”.

Pika tjetër bizneset jo formale edhe me ligj jemi të thirrur t’i ndalojmë !

Prandaj këtë pikë duhet tërësisht ta eliminojmë, sepse kjo pikë iu jep mundësi bizneseve jo formale të marrin të drejtën e tyre të regjistrohen si biznese fillestare dhe t’i kenë privilegjet e tyre. Unë mendoj se kjo pikë duhet tërësisht të eliminohet.

Mbi bazën e këtyre vërejtjeve mendoj se nuk ka asnjë justifikim financiar dhe për derisa ne mbështesim një vendim të tillë të lirimit të shumë bizneseve edhe prodhuese dhe jo prodhuese të bëjnë ngarkesa për bizneset të cilat ekzistojnë jo prodhuese me tarifa më të larta se që kanë qenë vitin e kaluar.

Për këtë arsye ne ato ngarkesa të shtuara nuk i mbështesim, sepse është jo logjike në një anë të mbështesim një vendim të tillë, kurse në anën tjetër pranojmë apo heshtazi i rrisim taksat për vitin, disa biznese që nuk janë në pajtim me këtë vendim.

Ramiz Ramadani – ato të cilat i tha z. Sadudini është qëndrimi i grupit tonë, por unë në emër timin e kam një vërejtje te pika e dytë ku flitet për bizneset jo formale të cilat ekzistojnë sot në Komunë. Është një anomali, sepse thuhet se të gjitha bizneset jo formale të cilat deri në fund të marsit regjistrohen, ato do të lirohen nga taksat në dy vitet e ardhshme.

Unë këtu nuk e kuptoj se cili biznes do të deklarohet se është jo formal dhe kërkon për ta gëzuar atë drejtë? Unë mendoj se ato biznese duhet të trajtohen si ato biznese që regjistrohen për herë të parë, mirëpo ndoshta duhet me një korrigjim që nëse inspektori i tregut e zbulon ndonjë biznes jo formal nuk do ta gëzon këtë të drejtë.

Sa i përket rritjeve që janë bërë drejtori i buxhetit tha se kryesisht nuk ka rritje, unë mendoj se kryesisht nuk ka zbritje.

Rritjet kryesisht janë prej fillimit, kurse zbritjet që po i përmend mendoj se janë shumë të parëndësishme. Shembull i tillë është ajo ku thuhet lirohen qumështoret nga 160 euro në 100 euro, unë e mbështesë atë që në këtë fushë duhet bërë lirim, por po iu njoftoj se vetëm një qumështore është në Komunë të Gjilanit. Unë mendoj se të gjitha këto ngritje duhet të korrigjohen, sepse te picerit nga 120 euro ngritja bëhet në 600

euro. Mandej te kafiteritë e kemi një ngritje në bazë të m² ku thotë të gjitha kafiteritë deri në 100m² ngritja bëhet në 150 euro, mandej nga 101-200m², prapë 150 euro dhe nuk ka ndryshime, kurse mbi 200m², 200 euro. Të gjitha këto ngritje për neve janë të papranueshme, kurse ne kërkojmë aty ku mundësi të bëhen zbritje, sepse është interes i qytetarëve dhe gjendja e bizneseve është e rëndë.

Në Drejtori të Bujqësisë janë disa propozime për gjoba, për të cilin propozim dua t' i them drejtorit se kjo është bërë me qëllimin më të mirë për ta parandaluar keqpërdorimin e pyllit, por aq sa unë kam arrit për ta konsultuar ligjin, mendoj se kjo fushë është e rregulluar me Ligjin e pylltarisë, përkatësisht neni 36 i cili në mënyrë të saktë i parasheh këto masa.

Me këto masa ne i dyfishojmë gjobat, prandaj Zyra ligjore këto gjëra duhet shikuar dhe duhet t' i bëjë përmirësimet.

Riad Rashiti – unë së pari kam vërejtje në emërtim rregullores, sepse nuk është ashtu si duhet, për arsye se përmendet fjala gjoba e cila sipas meje është mirë të hiqet dhe të quhet: rregullorja për tarifa, taksa dhe ngarkesa.

Te propozimet e reja edhe unë fillimisht e pata një hezitim, por ne si grup e kemi debatuar dhe nuk ka dallime me përjashtim që propozimet e reja të cilat janë përfshirë te pika 2 janë 15 tarifa të reja, mendoj se këtu duhet të përkrahe, sepse këto janë të liruara.

Unë mendoj është në rregull që në vendim të kryetarit i cili u propozua, të qartësohet qartë se cilat, sepse ka shumë ndërmarrje në Komunë që janë edhe prodhuese edhe shërbyese dhe tek këto raste të jetë një formulim 50% të tarifës bazë.

Gjithashtu edhe unë pajtohem me Sadudinin që pika 2 dhe 3, sepse bizneset jo formale është vështirë të identifikohen dhe koha për tre muaj është e shkurtër dhe është mirë që të jetë jo deri në mars, por së paku 6 muaj.

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspeksioni, duhet ta bëjë ftesën për të regjistruar biznese dhe duhet të jetë një bashkëpunim më i mirë me ATK-në.

Nuhi Nuhiu- unë kam prit që të thuhet gjërat në mënyrë më konkrete, por këtu po flitet në mënyrë të përgjithësuar e cila gjë fare nuk po më pëlqen. Shumë sinqerisht po e them se duhet të bëhet një analizë me e thellë e kësaj rregulloreje dhe jo vetëm të thuhet në mënyrë paushalle se ka ngritje. Duhet të përmenden shifrat saktë me arsyetimin pse është bërë kjo ngritje?

Z. Abdyl Aliu e thotë se kjo rregullore ka qenë desh të kalojë nëpër trupa, por unë nuk e di sa ka kaluar nëpër trupa të Kuvendit, por dëgjim publik kemi pasur në të cilin tubim kanë qenë qytetarët, por edhe përfaqësuesit e bizneseve. Mandej kjo rregullore është analizuar një kohë të gjatë në disa seanca edhe në Këshillin e drejtorëve.

Duhet ta keni të qartë se ngritje ka pasur vetëm te 50 biznese dhe duhet shkruar me radhë.

Shtrohet pyetje pse kompanitë publike e kanë pasur taksën 500 euro tash 1000, por aty janë edhe arsyetime pse ka ndodh kjo?

Pastaj e kemi se sigurimi i objekteve fizike 240 në 300 euro e cila nuk është rritje e madhe, sepse këto kompani kanë përfitime të mëdha të cilat i dini të gjithë.

Kafiteritë dhe diskobaret janë 600 euro dhe nëse kjo rregullore nuk aprovohet sot disko- baret do të mbesin me 120 euro si piceritë.

Nëse ju e lëni këtë rregullore si të vitit të kaluar, ne i kemi bërë disa gabime, por në këtë rast do të bëjmë gabim edhe më të madh.

Nga kjo shihet se disko-baret nuk kanë qenë të ngarkuara ose kanë qenë me 120 euro me piceritë, kurse ne i kemi ndarë 120 me 600.

Kazinot nuk kanë ekzistuar si biznes, kurse tash i kemi ngarkuar me 700 euro

Bastoret sportive prej 380-700 euro, kjo ka pasur ngritje, por ne duhet ta mbrojmë interesin e qytetarëve tanë dhe fëmijëve tanë, sepse këto janë masa ndëshkuese.

Bingo-lojërat e fatit, kurse transportin e kemi ndarë në transportin me autobus lokal 240, mandej transportin e udhëtarëve me autobus 350 euro dhe transportin e udhëtarëve ndërkombëtar 500 euro. Këto nuk i kemi pasur të ndara, por tash i kemi ndarë.

Në vijim të fjalës drejtori i Financave i theksoi edhe disa raste të tilla duke tërhequr vërejtjen se këto nuk janë rritje enorme ashtu siç po thuhet.

Ju lus që ta analizon mirë pse është bërë ngritje në disa raste dhe mos të thuhet në mënyrë të përgjithësuar se çdo tarifë ka ngritje!

Izmi Zeka- ju z. këshilltarë në fakt i keni dy materiale, por ato në fillim i sqaroi z. Sadri Arfi, shefi i Shërbimit të Kuvendit. Ai i fundit është në debat i cili është propozuar nga Këshilli i drejtorëve.

Tahir Arifi- e para ne nuk jemi të gjithë juristë dhe ekonomistë dhe e dyta i paskemi dy materiale dhe tash po e di se ky i fundit qenka i vlefshëm.

Drejtorin e kisha lut që ato që i tha tash ka qenë desh t' i thotë në fillim, sepse do ta kishim shumë më lehtë për ta kuptuar dhe qëndrimi i ynë do të ishte më ndryshe se ai që patëm në fillim. Po përsëris se ne të gjithë nuk jemi juristë dhe ekonomistë, prandaj na duhen sqarimet me kohë.

Qemajl Mustafa- ne së pari duhet të marrim qëndrim për lirim, rreth atij propozim-vendimit për lirim, ta formulojmë drejt ashtu si u dha kontributi ta miratojmë atë dhe mandej të shkojmë në miratim të rregullores.

Unë mendoj se është në rregull me propozimin, kurse ngatërresa qenka teknike.

Ne me të vërtetë kemi qenë shumë të kujdesshëm, sepse kategoritë të cilat janë me qindra në Komunë si mikro-aktivitete të biznesit nuk i kemi ngarkuar, por diku-diku nëse na është dhënë mundësia i kemi shkarkuar nga pak si janë shitoret e vogla dhe zejtaritë.

Ju ftoj që së pari ta marrim qëndrimin për lirim të këtyre kategorive me disa sqarime, kurse më vonë do të them diçka për taksat ndërtimore të cilat i përmendi z. Adyli.

Te bizneset jo formale të sqarohemi, sepse te e dyta jemi marrë vesh që prej ditës së regjistrimit lirohen prodhuesit për 5 vjet, kurse te tjetra (bizneset) prej ditës së regjistrimit për tri vjet, kurse te bizneset jo formale me qëllim është lënë një kohë e limituar prej 90 ditëve, sepse ato nuk duhet të gëzojnë komoditet dhe të regjistrohen kur të dëshirojnë!

Me qëllim është lënë fundi i marsit, sepse nuk kam desh t' i barazojë me bizneset e reja të cilat regjistrohen rishtas, kjo është një lloj gjëritje, sepse më shkurt për 1 vjet iu vlen lirimi, sepse janë jo formale. Kjo më tepër është aspekt edukues.

Taksa 1% të cilin e përmendi Abdyli, mendoj se është mundësia e vetme për disiplinim, edhe për ngritje të kapaciteteve në Komunë dhe për përkushtim më të madh të trupave për mbikëqyrje dhe inspektim të ndërtimit.

Ai që bënë tejkalime duhet të gjobitet 300%, i cili propozim del prej meje si kryetari i Komunës i cili propozim mendoj se prapë është i vogël. Mirëpo ne i kemi dhënë disa kufizime nëse kushtet urbanistike ende lejojnë dhe ato ndërtimore, atëherë mund të legalizohet dhe personi juridik dhe fizik i cili e ka bërë atë tejkalim nuk ka të drejtë në Urbanizëm të marrë leje ndërtimore dhe pëlqim urbanistik për dy vitet e ardhshme.

Elisah Ymeri – unë së pari po ndërlidhem me diskutimin e z. Abdyl Aliu që këto gjëra herëve të tjera të kalojnë edhe përmes Komitetit për Zhvillim Ekonomik, sepse ne mund ta japim kontributin tonë në mënyrë që këto gjëra të vijnë në Kuvend sa më të kompletuara.

Kjo është edhe anomali që nuk ka kaluar nëpër Komitet për Zhvillim Ekonomik, sepse ne këto gjëra i kishim vërejt dhe ky dokument do të ishte më i kompletuar.

Kam vërejtje në përgjithësi që gjërat e tilla mos të propozohen për pa kaluar nëpër komitet, sepse ato trupa të Kuvendit për këtë qëllim janë formuar.

Sa i përket vërejtje e kam një personale aty ku flitet për lejen e prerjes së asfaltit në rrugë është një propozim 70-50, por nuk e kam të qartë se çka është kjo 70-50, sepse do të duhej 50-70 euro ? Këtu do të duhej të jetë euro, por duhet edhe një çmim më arsyeshëm duke pasur parasysh më pastaj edhe renovimin e rrugës, sepse në çdo vend ku ndërtohen shtëpi, prehet asfalti! Ne duhet ta ndalojmë këtë dukuri në një mënyrë.

Është edhe një gabim (te vërtetimi që nuk posedon banesë) thuhet 2 deri në 500 euro, ndoshta do të duhej të jetë 2-5 euro.

Sabedin Kadriu- unë në një mbledhje të Kuvendit e kam thënë se ne nuk jemi për të bërë dikush shaka me neve, por po del që dikush përsëri ka bërë shaka me neve, sepse na i ka sjell dy dokumente dhe ne nuk kemi ditur të orientohejm!

A është bërë kjo me qëllim apo jo nuk e di, por kjo gjë nuk është në rregull.

Unë si e dëgjova kryetarin i cili tha se ka dallime 3 mijë euro, por sipas një llogaritje që e bërë shpejtë më dolën 7 mijë euro. Jam në dilemë kujt t' i besoj, këtij dokumenti, kryetarit apo drejtorit? Ka qenë mirë të definohen mirë këto gjëra?

Z. kryesues kam një propozim konkret dhe pajtohem me drejtorin që ka pasur shumë biznese të cilët i kanë ikur taksave dhe qenka bërë mirë që kanë hyrë në këtë sistem dhe paska bërë mirë që disa biznese i paska ndarë sipas fuqisë.

Propozimi im është shumë konkretë që taksat për bizneset ekzistuese që kanë qenë deri më sot të jenë ashtu si kanë qenë, mirëpo të propozohen të gjitha bizneset e reja për ta plotësuar atë taksë, sepse edhe në vitin e ardhshëm do të dalin ndonjë biznes që e kemi lënë anash. Propozimi im është kështu; “ taksa që ka qenë deri më sot të ekzistojë, por të futen bizneset e reja, sepse nuk është e moralshme për t' shtuar disa taksa disa bizneseve, kurse në anën tjetër po themi se brenda një kohe të shkurtër do të hiqen të gjitha taksat”! Atëherë pse po i shtojmë?

Vërejtje kemi për ata persona të cilët na i dërgojnë këto dokumente dhe mos të na sjellin në pozitë të keqe, sepse unë nuk e kam të qartë cilën taksë ta shikoj?

Z. kryesues propozimin tim dua ta propozoni për votim, për të cilin propozim deklarohen anëtarët e Kuvendit.

Abdyl Aliu- unë nuk flas shumë në Kuvend, por kur flas së pari e bëj një analizë dhe nuk flas kot asnjëherë. Unë së pari po replikoj me drejtorin për të cilin kam shumë gjëra, por vetëm një fakt po e them. Është te veprimtaritë afariste 2.6, ku thotë; 'prodhuesit e materialit ndërtimor, blloka, blloka të betonit, gypa të betonit, kuba, beton të gatshëm etj''

Kjo kategori nuk ka ngritje të taksës është 240 euro, kurse tjetra e ndërlidhur me te 2.29, ndërmarrjet ndërtimore, ndërtimi i ulët të vogla deri në 20 punëtorë ka qenë 280 euro, është bërë 850 euro. Kjo sipas llogarisë është një ngritje 25%.

Unë e thash se këtu është punuar pa logjikë, sepse këto ndërmarrje ndërtimore e kanë një ngritje 25% dhe këto punojnë me këtë materialin që nuk ka ngritje.

Materiali sipas meje ka qenë desh të lirohet, sepse këta punojnë me këtë material dhe iu krijohet një fitim.

E dyta është se u tha që ka pasur debate, por shtohet pyetja sa biznese kanë qenë në atë debat dhe sa qytetarë ka pasur në atë debat?

Debati është mbajtur sa për formalitet.

Izmi Zeka- duhet ta keni të qartë me Statut dhe ligj se kjo rregullore duhet të kalojë vetëm në KPF dhe në Kuvend.

Unë propozoj që rregulloren ta votojmë sot, kurse shefat e grupeve të takohen dhe ta bëjnë harmonizimin.

Arben Maliqi- unë po vërej se këtu ka disa gjëra të cilat duhet të përmirësohen dhe ka edhe diskriminime. Jam për atë që te veprimtaritë afariste neni 4, ku janë prodhuesit e pijeve alkoolike nuk ka rritje. Mirëpo si shembull ku ka diskriminim është te hotelet ka rritje prej 400-600 euro, te motelet ka rritje, kurse diskriminimi është te restorante, sepse prej 51m² deri në 200 m² nuk ka rritje, te ata 201- 250 m² përsëri nuk ka rritje, kurse ka rritje te restorante prej 351m²- 500 m² ka rritje. Mirëpo problemi është te kafiteritë ato që janë nën 100 metra tash ka rritje në 150 euro, te kafiteritë prej 100m² deri në 200m² dhe ato mbi 200m² nuk ka rritje fare. Kjo nuk është në rregull dhe ka diskriminime, duhet të bëhemi të njëjtë për të gjithë!

Qemajl Mustafa- duhet të jemi korrekt ndaj Komunës si institucion, ndaj buxhetit të Komunës dhe të jemi korrekt ndaj biznesit. Mos e stërholloni, nëse ka vend, mua më pëlqej ky propozimi dhe nëse dëshiron për të u takuar edhe njëherë komiteti për të lëviz majtas ose djathtas ndonjë aktivitet ne për gjithmonë jemi edhe në gjysmën e vitit dhe në çdo periudhë kohore. Mirëpo mos e stërholloni dhe mos mendoni se po iu kuptojnë, ata të tjerët jashtë se gjëja jeni për ata (për disa e kam fjalën).

E keni pasur materialin lexoni me rend dhe koncentrohuni ku ka pasur ngritje të vogël, ku zbritje dhe ku kemi lënë njësoj. Atë diferencën që e përmendi Sabedini prej 7 mijë eurove, ajo mund të jetë te bizneset e reja, por nuk është me të vjetrat, sepse ne i kemi llogaritur shumë kujdesshëm dhe neve na ka dal diferenca 3 mijë euro ose 10-12%.

Nuk ka rritje të taksës absolutisht dhe nëse e votojmë vendimin për lirim kemi zbritje mjaft të mirë të taksës. Arbeni askund nuk e thotë që qiratë janë enorme në qytet, sepse një kafiteri e vogël i paguan 1 mijë e 1.5 mijë euro në çdo muaj dhe nuk i vije

rëndë, kurse po i ardhka rëndë t' i paguajë 150 euro për komunën në çdo vit. Unë iu ftoj të jemi korrekt dhe racional

Arben Mehmeti – është mirë të dalim prej kësaj gjendje në interes të Kuvendit, unë kam propozim konkret, sepse po shihet se ka disharmoni mes qëndrimeve tona, do të thotë në mes të grupeve. Unë propozoj që Kuvendi t' ia bartë këtë përgjegjësi Komitetit për Politikë dhe Financa i cili do të vendos përfundimisht lidhur me këto.

Riad Rashiti- edhe unë e pranoj propozimin e Arbenit i cili është propozim i mirë, por jo ta bartë përgjegjësinë, por ta votojë Kuvendi, kurse përmirësimet t' i bëjë komiteti.

Sokol Haziri- unë kam një propozim pak më ndryshe për të gjitha temat që Kuvendi më mos të thirret pas Kërshëndellave, por të thirret para Kërshëndellave dhe para Vitit të Ri.

Po vërehet se nuk jemi asnjë në rregull dhe do të ishte mirë që këto festa t' i festojmë në mënyrë evropiane edhe ne gjilanasit.

E dyta ne do të jemi të njëjtë për temën e dytë siç biseduam dhe edhe pas dy apo më tepër muajve do të bisedojmë kështu. Realisht propozimi i shefit të grupit të LDK-së është me vend dhe mund ta harmonizojmë këtë rregullore edhe pak, por ne ta votojmë në parim për t' ia dhënë mundësinë që aty ku ka ndonjë ndërhyrje atë edhe ta bëjë.

Në fund ne në parim ta votojmë, kurse ta autorizojmë Komitetin për Politikë dhe Financa që të ndërhyjë në pika të caktuara edhe atë gjatë muajit janar për pa bërë shtyrje të skajshme.

Izmi Zeka- kush është që kjo rregullore të aprovohet në parim, kurse Komiteti për Politikë dhe Financa t' i bëjë ndërhyrje.

Gjithashtu edhe vendimin të cilin e lexon kryesuesi.

Aprovohet në parim pika 3 e rendit të punës : Propozim -Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoha komunale për vitin 2012 me 38 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse mbledhje e Komitetit për Politikë dhe Financa mbahet të enjten në ora 9.

4. Propozim –rregullorja për ndarjen e subvencioneve

Pika e katërt e rendit të punës me vendim të Kuvendit është shtyrë, sepse së pari duhet ta bëjë draftin Komisioni për akte normative

6. Propozim- vendimi për shpenzimet e varrimit

Izmi Zeka- për shkak se në këtë seancë gjenden përfaqësuesit e Bashkësisë Islame, propozoj që të marrim vendim lidhur me pikën e 6, propozim –vendimi për shpenzimet e varrimit në mënyrë që kryetari i BI-së mos të presin në sallë edhe më gjatë, kurse fjalën do ta ketë zyrtari ligjor z. Hevzi Matoshi

Hevzi Matoshi – Lidhur me propozimin e BI-së Dega në Gjilan për ta hartuar në rregullore për kompensim të varrimit në Komunën tonë, Komisioni për akte normative ka propozuar përfundimisht si në vijim: Nuk ekziston një bazë ligjore për hartimin e një rregullore të tillë dhe se me një rregullore të tillë nuk mund të prejudikohen paraprakisht çështjet se kush do të ofrojë shërbime të tilla?

Kuvendi mund të përcaktohet për pagesën e shërbimeve të varrimit dhe të zbatojë procedurat e prokurimit për zgjedhjen e përfitueseve më të mirë për shërbime të tilla.

Në pajtim me Ligjin për prokurim publik dhe financat publike.

Ky është një arsyetim i shkurtër dhe për këtë arsye anëtarët e Kuvendit e posedojnë vendimin me të cilin Kuvendi mund të përcaktohet për pagesën e shërbimeve, kurse procedurat tjera duhet të zbatohen sipas Ligjit të prokurimit.

Sadri Arifi- e lexon vendimin në të cilin thuhet: “obligohet Komuna e Gjilanit që t’i bartë të gjitha shpenzimet e varrimit me rastin e vdekjes së qytetarëve të Komunës së Gjilanit. Në kompensime të varrimit hyjnë: bartja e kufomës, hapja e varrit, blerja e dërrasave, apo sarkofagut dhe shpenzimet e tjera lidhur me varrim”

Përfituesi i këtyre shpenzimeve duhet të përzgjidhet përmes procedurës së tenderimit në pajtim me ligjin dhe nenin 15 për varreza dhe mirëmbajtje e tyre.

Izmi Zeka- vendimi do të merret tash, kurse procedurat e mëtejme nxirren sipas ligjeve të cilat janë në fuqi dhe ne nuk mund të bëjmë rregullore e cila bie ndesh me ligjin, por dhe nuk mund të paragjykojmë se kush do të jetë përfitues i këtij tenderi.

Me rëndësi është se tash e tutje Komuna po i merr përgjegjësitë për shpenzimet e varrimit të qytetarëve të cilët perëndojnë.

Në procedurë të tenderimit ka të drejtë për të konkurruar edhe BI-ja si të tjerët e cila edhe i ka përparësitë në kuptimin ligjor.

Qemajl Mustafa- është thënë nga drejtoresha në Departamentin e prokurimit që kërkohet një taksë e biznesit, një lloj formalizmi biznesor. Mirëpo BI-ja mund të konkurrojë në partneritet me ndonjë kompani.

Ne këtë tenderim po e bëjmë, sepse aty shpenzohen dhjetëra mijëra euro e të cilat duhet të shpenzohen me procedurë të hapur, por me këtë edhe vijmë tek një çmim konkurrues.

Ejup Haziri- ne po deklarojmë se grupi parlamentar i PDK-së është që të aprovohet ky vendim.

Arben Mehmeti- unë mendoj se qëndrimi i PDK-së është i vonshëm në këtë drejtim dhe grupi i këshilltarëve të LDK-së e ka mbështet edhe më herët këtë dokument me të cilin është desh të kryhet një obligim në raport me BI-në dhe qytetarët e Gjilanit.

Në këtë formë tash si është, realisht është ndryshe që ne si LDK kemi desh për ta realizuar këtë kërkesë të BI-së. Tash është tjetër procedurë, por është në konsultim me Zyrën ligjore e cila së bashku me të Prokurimit duhet t' i zbatojnë procedurat. Ne kemi kërkuar edhe në të kaluarën, sepse në disa komuna ka marrëveshje në mes të kryetarit të komunës dhe BI-së për t' i kryer këto shërbime, ndoshta edhe pa procedura të prokurimit dhe forma të tjera, mirëpo ajo nuk është realizuar dhe ne në këtë formë çfarë është ne e mbështesim dhe kërkojmë që sa më parë të zbatohet ky vendim.

Sokol Haziri- edhe AAK e mbështet pa rezervë këtë propozim-vendim.

Arben Maliqi- edhe ne mbështesim këtë propozim-vendim

Xhemajl Salihu- me qenë se po bëhet një punë e mirë dhe e qëlluar, unë mendoj se është mirë dhe është ligjore që çdo person që e përfundon jetën, para se të varroset është mirë të merret fletë vdekja në QKMF. Me atë fletë vdekje fillon procedura për varrim të atij qytetari. Në vendim të hyjë edhe një pasues që prej ditës që hyn ky vendim në fuqi, qytetarët e Komunës së Gjilanit, nuk kanë nevojë të lajmërohen në Departamentin e pensioneve, sepse me këtë vendim çdo procedurë hyn në sistem.

Izmi Zeka- dëshira jonë ka qenë që këtë procedurë ta kryejë BI-ja, por duhet zbatuar ligjet, të cilat nuk mund t' i anashkalojmë. Është procedura dhe bëhet shpallja e tenderit në të cilën do të konkurrojë edhe BI. Mirëpo e rëndësishme është që qytetarëve po iu ofrohet një zgjidhje dhe shërbim të cilin nuk e kanë pasur deri më tash.

Ju lus të deklarohej se kush është për aprovim të këtij propozim- vendimi?

Aprovohet pika 6 e rendit të punës: Propozim vendimi për shpenzimet e varrimit me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

5. Propozim- rregullorja për ndarjen e titujve të nderit, mirënjohjeve dhe shpërblimeve

Izmi Zeka- këtë rregullore e kemi pasur njëherë në shqyrtim të cilën besoj se e keni lexuar të gjithë, prandaj ju lus që të deklaroheni se kush është për aprovim të kësaj rregulloreje?

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit pika 5 e rendit të punës: Propozim- rregullorja për ndarjen e titujve të nderit, mirënjohjeve dhe shpërblimeve

11. Miratimi i raportit nga takimi i KKS-së të datës 20.7.2011

12. Miratimi i raportit nga takimi i KKS-së të datës 1.8. 2011

Izmi Zeka- të gjithë anëtarët e Kuvendit, këto raporte i kanë pasur së bashku me materialet e tjera, prandaj ju lus që të deklaroheni se kush është për aprovim të këtyre dy raporteve.

Aprovohet pika 11 dhe 12 e rendit të punës me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit

8. Miratimi i planit të veprimit 2011-2012 të KKSB në Komunën e Gjilanit

Izmi Zeka- lidhur me këtë fjalën ia barti zv/kryetarit të komunës z. Omer Dakut

Omer Daku- sipas një udhëzimi administrativ i cili është nga Ministria e Punëve të Brendshme nr.8 /2009 dhe nr.2 të MPL-së të datës 20.3.2009, obligohet KKSB-ja që të gjitha takimet që mbahen t' i sjell ato materiale në Kuvend dhe natyrisht ato të aprovohen. Në të dy takimet të cilat i kemi mbajtur keni mundësi për të parë se në kuadër të kësaj kemi pasur edhe pika konkrete që është punuar në drejtim të hartimit të planit të veprimit. Ne e kemi vlerësuar vitin 2011-2013, duke u munduar që ta përfshijmë edhe pjesën e mbetur të vitit 2011 të jetë e përfshirë e cila gjë është edhe ashtu, por vetëm pjesa e fundit edhe pse ne në seancën paraprake e kemi menduar se do të futet në rend të ditës.

Ne në këtë plan të veprimit jemi munduar që ta bëjmë një ekip dhe përfaqësim të mirë të cilët mund të japin kontributin për hartim të planit të veprimit për të cilin duhet theksuar se jemi të obliguar sipas udhëzimit administrativ që të gjitha komunat ta kenë edhe planin e veprimit. Në këtë përbërje kemi pasur përfaqësuese të subjekteve të ndryshme politike dhe nëse diku nuk është parë ndonjë ndikim politik, atëherë është në këtë grup, i cili grup ka dhënë maksimumin pa ndonjë kompensim material i cili ka qenë vullnetar, por ka qenë grup i përgjegjshëm i cili ka bërë një punë jashtëzakonisht të mirë. Në kuadër të këtij plani i kemi bërë disa parapërgatitje dhe kemi kontaktuar edhe me një OJQ (.....) nga e cila kemi kërkuar që të na asistojë në aspektin profesional dhe në ndërkohë edhe material nëse është e mundur.

Fatmirësisht për këtë kanë ndodhur të dyja, sepse kemi arrit që pas një pune të konsiderueshme na është mundësuar që përmes Qeverisë Holandeze të përfitojmë edhe një mbështetje materiale dhe na janë hequr të gjitha shpenzimet të cilat i kemi bërë për 4 ditë në Durrës ku e kemi bërë edhe finalizimin e këtij plani të veprimit.

Në këtë grup kemi pasur edhe përfaqësues të komuniteteve të tjera, turqit, romët serbët dhe që të gjithë kemi vepruar së bashku.

Në vijim të fjalës së tij z. Daku në pika të shkurtra e elaboroi këtë plan të cilin anëtarët e Kuvendit e kanë së bashku me materialin.

Izmi Zeka – në këtë këshillë marrin pjesë të gjitha përfaqësimet politike dhe unë jam që të aprovohet ky plan.

Nuk pati debatues lidhur me këtë pikë dhe kryesuesi propozon që miratohet kjo pikë e rendit të punës.

Aprovohet pika 8 e rendit të punës : miratimi i planit të veprimit 2011-2012 të KKSB-së në Komunën e Gjilanit, me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit

Të ndryshme

Sokol Haziri- duhet të bëhet një përmirësim në Komisionin për akte normative nga përfaqësuesi i AAK-së, sepse janë paraqitur probleme me prokurim, prandaj në vend të Sokol Hazirit të jetë Sami Azemi.

Aprovohet ky ndryshim në Komisionin për akte normative

Arben Maliqi- unë e kam një kërkesë për lagjen “Sadik Sadiku”, sepse në atë lagje qytetarët kanë probleme të mëdha për të shkuar në shtëpitë e veta, të cilën gjë e kam përmendur edhe më parë. Koj lagje është te ish ëmbëltorja “Skënderbeu”. Ata qytetarët kanë vështirësi për të hyrë në shtëpitë e tyre me automjete, iu lus që të vendoset një shenjë komunikacioni që mos të ketë parking dhe ndalim të veturave. Këtë duhet ta merrni seriozisht!

Izmi Zeka- lidhur me materialet që u përmenden, po theksoj se për këtë arsye iu kemi sjell llap-topët në të cilët i keni të gjitha materialet.

Drejtorët i lus që çështjet të cilat i kanë t’i fusin në plan të punës për vitin 2012, sepse më vonë nuk do t’i fusim fare. Këto i sillni me kohë, sepse duhet aprovuar një plan të punës për vitin 2012.

Me këtë mori fund seanca e njëzetetretë dhe e fundit për vitin 2011, duke iu uruar të gjithë të pranishmëve sukses dhe shëndet në vitin vijues 2012.

Seanca i përfundoi punimet në ora 14.00

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA